



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Nr. Prot. 07	Nr. Prot. 491
Org. Zënorë	Org. Zënorë
Org. Uniti	Org. Uniti
Nr. - Ekipave	Data: 27.03.2026
Nr. - Shprehës	Data: 27.03.2026
Nr. - Paqeje	Date: 27.03.2026
PRISHTINE A NO.1	

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve/MAPL
Përmes:	Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë <i>p.p. Çarçaku</i> Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë
Nga:	Deniza Krasniqi, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor/ME <i>D. Krasniqi</i> Datë: 10.03.2026
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Dëfrim Pllashniku, Udhëheqës i Divizionit për Politika të NP/NJPMNP <i>D. Pllashniku</i> Arbërore Bërnica-Hasani, Analiste ligjore/NJPMNP
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Pejës
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 06/2026 i Kuvendit të Komunës së Pejës

I nderuar Kryetar z. Muhaxheri,
I nderuar Kryesues z. Kurtbogaj,

Ministria e Ekonomisë ka pranuar kërkesën nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me Nr. prot. 342 datë 05.03.2026, për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal të Komunës së Pejës Vendimin Nr.06/2026 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale (N.P.L.) " AMBIENTI " Sh.A., të miratuar më datë 26.02.2026 nga Kuvendi Komunal i Pejës

Bazuar në nenin 9, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave dhe legjislacionin përkatës për Ndërmarrje Publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, vlerëson se Vendimin Nr.06/2026 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të

Ndërmarrjes Publike Lokale (N.P.L.) " AMBIENTI " Sh.A., është në përputhje me nenin 5.2 të ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Arsyetim

Neni 5 paragrafi 5.2. i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton se në rastet kur një komunë është aksionare në një Ndërmarrje Publike Lokale, të drejtat e saj si aksionare ushtrohen përmes Komisionit Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar."

Mbi këtë bazë, Vendimi i Komunës së Pejës që përcakton përbërjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, me kompetencë për të vepruar në emër të komunës përkatëse, është në harmoni me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.

Ministria e Ekonomisë mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çdo sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt,

*** Vlerësimi i dhënë nga Ministria e Ekonomisë përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin e Ministrisë së Ekonomisë si sponsorizuese e legjislacionit për Ndërmarrjet Publike***